



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Alko Impex General Construction" Sh.P.K. të datës 07.03.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i pilotave betonarme në lagjen Kalabri" me nr. të prokurimit 616-24-1880-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Alko Impex General Construction" Sh.P.K. e datës 07.03.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i pilotave betonarme në lagjen Kalabri" me nr. të prokurimit 616-24-1880-5-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Alko Impex General Construction" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Alko Impex General Construction" Sh.P.K. (tutje "parashtuesi") me datë 07.03.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i pilotave betonarme në lagjen Kalabri" me nr. të prokurimit 616-24-1880-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: “

- I. *Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa: Menaxher i projektit (kontratës) Vërejtje Menaxheri duhet të jetë me profesion nga fusha e Arkitekturës . Deshmija e kerkuar: • Diplomë universitare e programit Master (apo 4 vjetë e sipër, programi i vjetër në Kosovë) – Kopje e Noterizuar; • Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; • Dy (2) kontrata të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat origjinale apo të noterizuara; • Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; • Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min. 5 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontrates (Kontratave me punëdhënësit) së punës; Kërkesa e lartecur e tenderit me titull Ndërtimi i Pilotave Betonarme në lagjen Kalabri 616-24-1880-5- 2-1 nuk është e arsyeshme sepse: Ing. I Arkitektures nuk mund të mbikeqyr apo të menaxhon punet të cilat janë specifikisht të ing. të ndertimtarisë/ drejtimit konstruktiv. Dimenzionimi, Llogaritja statike si e pilotave poashtu edhe të murit mbrojtës behet nga ing. I ndertimtarisë/ drejtimit konstruktiv. Mbikeqyrja si dhe menaxhimi i punëve duhet të jete nga Ing. I ndertimtarisë i cili është I kesaj fushe profesionale. Paramasa dhe parallogaria permban pozicionin 1.4. ku kerkohet hartimi I projektit të ekzekutuar, poashtu e behet nga Ing. I ndertimtarisë/ konstruktiv me ndihmen e Programeve software per llogaritje statike qe klasifikohen si programe të inxhinjerise se ndertimit jo të arkitektures. Andaj ing. i Arkitektures dhe dy referenca të cilat kerkohen në kete lemi nga ing. I arkitektures është absurde sepse kerkohet referenca në punet të cilat nuk janë pune dhe profesioni Ing. të arkitektures. Kërkesa jone është të hiqet ky kriter dhe të kerkohet ing i fushes profesionale qe i pergjigjet ketij projekti.*
- II. *Per gjithë stafin profesional kerkohet deshmi per pervojë të punës: • Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min. 3 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës; Per deshmi të punës janë kerkuar referenca dhe kontratat me punedhenesit. Kontratat me punedhenesit të meparshem janë konfidenciale dhe me kete kerkese ju I cenoni të drejtat e privatesise të një individi, kontrata permbane informata personale dhe konfidenciale nga edhe ka mundesi të rrjedhin mos pajtimet apo edhe keqekuptimet nga punedhenesit të tashem. Andaj mendojem se referencat apo edhe lista e pagave nga ATK-ja, është kerkese e mjaftueshme për të u deshmuar pervoja e punës. Kërkesa jone është të hiqet ky kriter.*
- III. *Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa: Një (1) Inxhinier i Elektroteknikës – Drejtimi Energjetikë. Dëshmia e kërkuar dokumentare; • Diplomë universitare e programit master (apo 4 vjet e sipër, programi i vjetër në Kosovë) – Kopje e Noterizuar; • Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; • Një (1) kontratë të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat origjinale apo të noterizuara; • Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; • Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min. 3 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës; Kërkesa e lartecur e tenderit me titull Ndërtimi i Pilotave Betonarme në lagjen Kalabri 616-24-1880-5- 2-1, nuk është e arsyeshme sepse: Ne çfare faze ose pune do të jete ky ing. I angazhuar kur nuk ka asnje pozicion të elektrikes në paramase dhe asnje pune e cila nderlidhet me ing. e Elektroteknikes nuk është. Kërkesa jone është të hiqet ky kriter”.*

Lidhur me pretendimin e parë ankimor, parashtruesi ka argumentuar se kërkesa që menaxheri i projektit duhet të jetë nga fusha e arkitekturës nuk është formuluar në kuptim të nenit 7 par. 2 të LPP pasi që *"Ing. I Arkitektures nuk mund te mbikeqyr apo te menaxhon punet te cilat jane specifikisht te ing. te ndertimtarise/ drejtimit konsruktiv. Dimenzionimi, Llogaritja statike si e pilotave poashtu edhe te murit mbrojtes behet nga ing. I ndertimtarise/ drejtimi konstruktiv. Mbikeqyrja si dhe menaxhimi i puneve duhet te jete nga Ing. I ndertimtarise i cili eshte I kesaj fushe profesionale. Kerkesa jone eshte te hiqet ky kriter dhe te kerkohet ing i fushes profesionale qe i pergjigjet ketij projekti"*. Së këndejmi është gjetur se ky pretendim ankimor është i bazuar ndërsa kërkesa e dosjes së tenderit duhet të riformulohet. Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik"*.

Sa i përket pretendimit të dy dhe të tretë ankimor, parashtruesi vetëm ka kërkuar që të largohen kërkesat përkatëse të dosjes së tenderit mirëpo nuk ka parashtruar asnjë argument të vetëm për të mbështetur këto pretendime të tij. Prandaj pretendimet ankimore janë gjetur si tërësisht të pabazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij të parë ankimor mirëpo jo edhe për pretendimin e tij të dytë ose të tretë. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar vetëm pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.03.2024

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komunase Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.